

## NË EMER TË POPULLIT

**Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i pergjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla , në lëndën penale kundër të pandehurit Xh. R.për shkak të veprës penale, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, të cilin e ka mbrojtur, av..., duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, , të cilin e përfaqësonte Prokurorja e shtetit, Huma Jetishi, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më 26.10.2016, shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

**I pandehurit Xh. R.**nga baba Sh..dhe nëna Z..., e lindur R., i lindur më ..në G, me vendëbanim në lagjen..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar , i martuar, , i gjendjes së varfër ekonomike , shqiptar , Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

### Ë S H T Ë FAJTOR

S e p s e më.., rreth orës ..minuta , në Gjnë lokale të , nga mllefi, e ka sulmuar T. Sh, polic në këtë stacion, që ishte angazhuar për ta intervistuar këtë në cilësi të dëshmitariut për një rast që një ditë më parë ishte paraqitur, edhe atë gjatë kohës deri sa i njejt i ishte duke e krye detyrën e tij zyrtare, në atë mënyrë që në fillim e fyen, më pastaj e kap me duar për gjokësësi dhe e sulmon dhe në fundë e kanos duke i thënë"deri sa të më rreh një damar, ju nuk do të kaloni lehtë" me ç'rast të dëmtuarit i shkakton edhe lëndime të trupore në formë të gërvishtjeve të gërvishtjeve të indit lëkuror të regjionit të gjoksit në anën e majtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin, për të cilat të njejt i është ofruar edhe ndihma e nevojshme mjekësore nga Emergjenca e Spitalit Regjional të ....

-me çka ka kryer veprën penale, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipërthekësuar ligjore si dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45,46 47, 73, 74, 75, 76 dhe 83 të KPRK-ës si dhe nenit 233 dhe 365 të KPP-të pandehurvë,iu shqipton:

### **DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT ZËVENDSOHET NË DËNIMIN ME GJOBË**

Ashtu që të pandehurit Xh.Ri i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 145 (njëqind e dyzet e pesë) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 1.200€ (njëmijë e dyqind) Euro

Dënimin me gjobë në shumën prej...,i pandehuri do ta paguajë në afat prej 3 (tre) muajve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Pagesa bëhet në këste të barabarta për çdo fillim të muajit duke e përpjestuar shumën e përgjithshme të dënimit me gjobë, në të kundërtën mundësia e pagesës në këste mujore do të revokohet.

Të pandehurit në dënimin e shqiptuar iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data.....

Nëse i pandehuri i sipërtheksuar nuk dëshiron ose nuk mundet që të bëjë pagesën e dënimit me gjobë në shumën si më lartë, atëherë të njejtit, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, duke iu llogaritur një ditë burgim me njëzet (20) Euro gjobë.

Detyrohet i pandehuri e sipërtheksuar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej ( njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr., kundër të pandehurit, për shkak të veprës penale, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan me 24.10.2016 ka paraqitur marrëveshjen për pranim të fajësisë, të nënshkruar nga Prokurori i shtetit, Ismet Ukshini, i pandehuri Xh. R. dhe mbrojtësi i tij, av. ....me autorizim si në shkresat e lëndës.

Gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë prezentuar Prokuroja e shtetit Huma Jetishi, i pandehuri Xh. R. me mbrojtësin e tij, av. ....si dhe i dëmtuari T. Sh.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se kemi pranuar kërkesat për fillimin e negociimit për pranimin e fajësisë më datë, pastaj prokurori i çështjes ka marrur autorizim nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Shtetit të PTHDP në Gjilan, dhe kemi filluar të negocojmë me të pandehurin e sipërtheksuar si dhe mbrojtësit e tij kështu që me, është arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me të pandehurin Xh. R dhe mbrojtësin e tij, av. ....Prandaj mbes në tërsi pranë marrëveshjes për pranim të fajësisë nga se janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të Kodit të procedurës penale.

Mbrojtësi i të pandehurit Xh. R, av. ...ka deklaruar : pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin tim, kemi marritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë, përmes së cilës është rekomanduar edhe dënimi, andaj i propozojmë gjykatës që këtë marrëveshje ta pranojë, sepse e njejtja është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke kërkuar nga gjykata që me rasin e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënimin me gjobë, të ketë parasysh faktin se i njejtja është mbajtës i familjes, dhe me gjendje të varfëe ekonomike.

I pandehuri Xh. R. në fjalën e tij deklaroi : në tërsi e mbështesë deklaratën e mbrojtësit tim, nga fakti se edhe unë jam dakorduar për marrëveshjen e arritur të cilën edhe e kam nënshkruar.

Pas dëgjimit të deklaratëve të palëve, e në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21, lidhur me nenin 18 të KPPK-së, gjykata konstatoj se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë, lidhur mes PTH-së – DP, në njërën anë, dhe të pandehurit Xh. R. me mbrojtësin e tij av. ....në anën tjetër për kryerjen e veprave penale, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 233 paragrafi 21, të KPPK-së, vendosi që data e sotme të jetë data kur palët ti japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin, e që një gjë e tillë është bërë menjëherë.

Prokurorja e shtetit deklaroi : Mbetem në tërësi pranë marrëveshjes lëndore të nënshkruara nga palët, duke u pajtuar edhe me dënimin.

I dëmtuari, ka deklaruar, unë i fali gabimin të pandehurit, si dher heq dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit..., deklaroi: si në fillim por edhe tani theksoi faktin se marrëveshja është arritur në pajtim me dispozitat ligjore se dhe dakordimin e të pandehurit, kështu që kërkoi nga gjykata që të njejtën ta aprovoi, ndërsa sa i përket zëvendësimit të dënimit me burg në dënimin me gjobë, kërkoi nga gjykata, që të ketë parsysh faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes dhe i gjendjes së varfër ekonomike.

I pandehuri Xh. R, deklaroi e mbështes deklaraten e mbrojtësit tim, pendohem për veprën e kryer dhe në fund i premtoi gjykatës se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të këtilla apo të ngjashme penale.

Pas pranimit të marrëveshjeve për pranimin të fajësisë për veprat penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës me numër dhe datë të shënuar si më lart , si dhe deklaratave të palëve lidhur me dënimin, gjykata të pandehurin , e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21 i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit . Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të njejtin do ta parandaloj që të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale dhe se ky dënim do të ndikoj edhe tek qytetarët e tjerë.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së.

**Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i përgjithshëm**  
**Më 26.10.2016**

**Sekretarja juridike**  
**Rafete Sylaj, d.v.**

**G j y q t a r i**  
**Islam Thaçi, d.v.**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

**P.nr.41/2015**

**NE EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem,** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Vlora Selmani – Rahimi, në lëndën penale kundër të pandehurit : Lulzim Shabani nga fsh.Kufcë e Epërme , Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.796/2015, të datës 12.06.2015, të cilin e përfaqësonte Prokurorja e shtetit, Rozelida Hasani , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor dhe publik më 19.10.2015, shpalli publikisht dhe hartoi këtë,

**A K T G J Y K I M**

*I pandehuri, Lulzim Shabani , nga babai , Sabri , dhe nëna, Nexharije , e lindur, Musliu , i lindur më 03.05.1979 , në fsh. Zarbincë , ndërsa tani jeton në Gjilan , në rrugën ,, Metush Krasniqi,, i martuar, prind i 3 fëmijëve , ka të kryer shkollën fillore, i punësuar, i gjendjes së varfer ekonomike , shqiptar , Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar për vepër penale, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,*

### **është fajtor**

*Me date 16.05.2015, rreth orës 14.30 min , në rrugën rajonale të fshatit Zhegër – Stanqiq , afër kompanis,, Euro Dema ,, i pandehuri Lulzim Shabani , duke drejtuar automjetin e markës ,, Mercedes,, me tabela të regjistrimit BU-012-BY, me ngjyrë të kuqe , ka vepruar në kundërshtim të dispozitës lifjore 54.1 të LSKRR-së , ashtu që të kontrolloj mjetin në kushtet egzistuese të komunikacionit , posaqërisht duke pas parasysh pamjen , dhe dukshmërinë e rrugës , nuk ka mbajtur distancën e mjaftueshme dhe nuk e ka përshtat shpejtësinë e lëvizjes , në atë mënyrë që nga rruga dytësore nga ana e majtë , papritmas del në rrugën kryesore , i dëmtuari –i mituri me inicialet V. RR , nga fshati Zhegër , që ngiste bicikletë , ashtu që i pandehuri në pamundësi që ta ndal veturën , e godet të miturin , ku i shkakton lëndime të lehta trupore i cili nga lëndimet e marra detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore , në Spitalin Regjional të Gjilanit – emergjenca me nr. 9130 të dt. 16.05.2015 .*

*Me çka ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së .*

*Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73,74,75,dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqipton,*

### **Dënim me kusht**

*Ashtu që të pandehurit Lulzim Shabani , i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindë e njëzet) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda afatit prej 1 (një) viti , nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t` ju revokuar.*

*I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojnë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.*

1.-

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.796/2015, të datës 12.06.2015 ,kundër të pandehurit, Lulzim Shabani nga fsh.Llabjan , Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.*

*Prokuroria Themelore Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan me 12.06.2015, ka paraqitur marrëveshjen për praninë të fajësis , me datë dhe numër të shënuar si më lart , të nënshkruar nga Prokurori i shtetit , i pandehuri dhe mbrojtësi i tij av . Begzad Hajrullahu.,*

*Gjykata ka mbajtur seancën fillestare për shqyrtim gjyqësor në të cilën kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit, Rozelida Hasani , i pandehuri, Lulzim Shabani me mbrojtësin*

e tij sipas autorizimit av. Begzad Hajrullahu nga Gjilani ,dhe përfaqësuesi ligjor Ibrahim Rustemi - babai i të dëmtuarit të mitur Valton Rustemi .

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se mbes në tërsi pranë marrëveshjes për pranim të fajësisë duke u bazuar në nenin 233 të Kodit të procedurës penale , të dates 12.06.2015 , kemi arritur marrveshje me të pandehurin Lulzim Shabani , për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin të KPRK-së , me të cilin rast i njejt është pajtuar që të pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës , edhe atë gjithnjë , në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e tij .

Mbrojtësi i të pandehurit avokati ,Begzad Hajrullahu deklaroi : Siq theksoj dhe Prokurorja e shtetit pas konsultimeve të bëra me klinentin tim Lulzim Shabani me 03.06.2015 , pranë Prokuroris Themlore në Gjilan , kemi dorëzuar kërkesën per negociimin e marrëveshjes për pranim të fajësisë , në lidhje me veprën penale ,Rrezikim I trafikut public nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së , ndërsa me 12 .06.2015 , kemi arritur marrëveshje për pranim të fajësis , në mënyrë që i mbrojturi im të përfiton të gjitha benifitet që janë të përcaktura në dispozitat ligjore .

I pandehuri Lulzim Shabani deklaroi : Në tërsi mbetet në deklaratën e mbrojtësit dhe nuk kam asgjë qfarë të shtoj .

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësis se pranimi i fajsis është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri edhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij avokatin ,Begzad Hajrullahu , se i pandehuri nuk ka qenë i shtrënguar për të pranuar fajësinë , pastaj pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk egziston asnjë nga rrethanat e parashikuara në nenin 253 paragrafi 1 dhe 2 i KPPK-së .

Nga arsyet e cekura si më lart e në mbeshtetje të nenit 233 paragrafi 21 të KPPK-së , gjykata konstatoj se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj , andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë , lidhur mes PTH-së – DP , në njërën anë , dhe të pandehurit Lulzim Shabani me mbrojtësinë e tij avokatin Begzad Hajrullahu , në anën tjetër për kryerjen e veprës penale , sipas dispozitivit të aktakuzës PP. II. nr.769/2015 të datës 12.06.2015 .

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve dhe ne bazë të nenit 233 paragrafi 21 , fjalia e dytë të KPPK-së , po ashtu vendosi që data e sotme të jetë data kur palët ti japin deklaratat e tyre ne lidhje me dënimin , e që një gjë e tillë do të bëhet tani .

Prokurorja e shtetit Rozelida Hasani deklaroi : Duke marrë parasysh se janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore te parapara sipas kodit 233 për lidhur me marrveshjen për pranim të fajësis , si dhe të gjitha rrethnat lehtësuese të cilat shkojnë në favor të të pandehurit , atëherë unë si Prokurorore mbetem në tërsi pranë marrëveshjes lëndore te datës 12.06.2015 , me PP. II. Nr. 769/2015 , e lidhur me të pandehurin Lulzim Shabani , për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së , dhe kerkoj nga gjykata që ta aprovoj kërkesen e prezentuar .

2.-

Prindi i të dëmtuarit – miturit Valton Rustemi ,Ibrahim Rustemi deklaroi se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale , dhe nuk kërkoj kompensim material , për shkak se djalin e kam mire me shëndet dhe kërkoj nga gjykata që i pandehuri të mos dënohet .

Mbrojtësi i të pandehurit të mitur Valton Rustemi , avokati, Begzad Hajrullahu deklaroi se ne kemi arrit marrëveshje për pranim të fajësisë , dhe theksoj faktin se i dëmtuari prindi, Ibrahim Rustemi nuk kërkon që i mbrojturi im të dënohet , dhe kërkoj nga gjykata që të aprovoj marrëveshjen si të tillë .

Pas pranimit të marrëveshjes të pranimit të fajësis për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv me numër dhe datë të shënuar si më lart , si dhe deklaratave te palëve lidhur me dënimin gjykata të pandehurin Lulzim Shabani , e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21 i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit . Me dënimin e shqiptuar të

pandehurit gjykata vlersëon se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandaloj që të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale dhe se ky dënim do të ndikoj pozitivisht edhe tek qytetarët e tjerë , dhe se do të përmbahet nga kryerja e veprave të ngjshme penale .

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.  
**Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem**  
**P.nr. 36/2015, më 19.10.2015**

**Sekretarja juridike**  
**Vlora Selmani – Rahimi**

**Gj y q t a r i**  
**Islam Thaçi**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

3.-

**P.nr.40/2015**

### **NE EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem,** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Vlora Selmani – Rahimi, në lëndën penale kundër të pandehurve : Bujar Jamrich nga Vushtria dhe Shpejtim Osmani nga fsh.Llabjan , Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjiilan, PP.II.nr.1186/2015, të datës 30.07.2015, të cilin e përfaqësonte Prokurorja e shtetit, Kujtesë Fazliu , pas mbajtjes së shqyrtimit filllestar gjyqësor dhe publik më 19.10.2015, shpalli publikisht dhe hartoi këtë,

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri, Shpejtim Osmani, nga babai, Murtez, dhe nëna, Qibrje, e lindur, Shabani, i lindur më 12.06.1981, në fsh. Llabjan, ku edhe jeton Komuna e Novobërdës, i martuar, prind i 4 fëmijëve, ka të kryer 3 vjet të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së varfer ekonomike – shfrytëzues i ndihmës sociale, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar për vepër penale, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

### **është fajtor**

Ditën, kohën dhe vendin e përmendur si në dispozitivin e I, të kësaj aktkauze, ka shkelur paragrafin 55.1 të nenit 55 të LSKRR-së, dhe me këtë ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës „Opel Vectra“, me ngjyrë hiri metalike, dhe me targa të regjistrimit 06-128-BO, nuk ju është përmbajtur dispozitive të ligjit në fjalë, që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit sipas të cilit shoferi është i obliguar që të mos frenoj vullshëm përveq në rast të rrezikut të drejtpërdrejt, dhe atë duke e paralajmëruar me sinjalizim të dritave të frenimit, dhe me gjithë treguesit e drejtimit ose duke dhënë shenjën përkatëse me dorë, lehtë ka menduar se edhe përkundër veprimeve nuk do të shkaktoj pasojnë e ndaluar, ashtu që me të arritur në vendin e përmendur vullshëm frenon pa dhënë kurrëfar shenje, për shkak se nga ana e kundërt vëren se ishte duke ardhur automjeti i policisë, me që rast e pengon duke zhvilluar shpejtësi normale të pandehurin e parë që ishte prapa tij, duke e drejtuar automjetin e markës „Mercedes“, me ngjyrë hiri dhe me traga të regjistrimit 01-483-AF, dhe për pasojë nga prapa goditet prej këtij automjeti dhe me këtë rast përveq dëmeve material në vlerë të pa përcaktuar në automjetin e të pandehurit të parë, bashkëudhëtarve të vet – tani të dëmtuarve: Qibrje, Shqipe, Fidan, Besart, dhe Gentuar Osmani ju shkakton lëndime të lehta trupore në formë të ndryshjeve, dhe përdredhjeve në pjesë të ndryshme të trupit.

Me çka ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73,74,75,dhe76 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurëve, iu shqipton,

### **Dënim me kusht**

Ashtu që të pandehurit Shpejtim Osmani, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzikutohet nëse i pandehuri brenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t`ju revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

Të dëmtuarit: Qibrje, Shqipe, Fidan, Besart, Gentuar Osmani, nga fshati Llabjan, Komuna e Novobërdës, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në contest civil.

1.-

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurëve: Bujar Jamrich nga Vushtrria dhe Shpejtim Osmani nga fsh. Llabjan, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

Gjykata ka mbajtur seancën fillestare për shqyrtim gjyqësor në të cilën kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit, Kujtesë Fazliu, i pandehuri, Shpejtim Osmani, dhe të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarve: Qibrje Osmani, Shqipe Osmani, si dhe të miturit Fidan, Gentuar, dhe Besart Osmani, të përfaqësuar nga nëna e tyre, ndërsa ka munguar i pandehuri Bujar Jamrich, për të cilin në fletkthesë thuhet se i njejt jeton në Austri.



Gjykata duke vepruar në bazë të nenit 36 të Kodit të procedurës Penale, e më qëllim të efikasitetit, veçoi procedurën penale ndaj të pandehurit Bujar Jamrich nga Vushtrria , për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe veçimi i lëndës ndaj të pandehurit të lartëcekur , do të merr numër të ri sipas radhës .

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri, Shpejtim Osmani e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 paragrafi 1 i KPRK-së, e pas këtij njoftimi i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale të kryer, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të akuzës.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare theksoj:mbesë në tërsi pranë aktit akuzues, pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestarë i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon akuza, e për të cilin pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favorët e pranimit të fajsisë, mbi bazën e këtij pranimi dhe provave materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të pandehurin t'a shpalli fajtor dhe t'i shqiptoi dënim meritor në pajtim me kodin penal.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata duhet të ketë parasysh , shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore.

E dëmtuara, Qibrije Osmani, në fjalën përfundimtare deklaroj : se nuk i bashkangjitem ndjekjes penale , ndërsa kërkoj kompenzimin e dëmit material .

Edhe e dëmtuara, Shqipe Osmani- njëkohësisht përfaqësuesja ligjore- nëna e të miturve Fidan, Besart , dhe Gentuar Osmani , fjalën përfundimtare deklaroj :Se nuk i bashkangjitem ndjekjes penale , ndërsa kërkoj kompenzimin e dëmit material për vete dhe fëmijët e mitur .

I pandehuri Shpejtim Osmani deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilin, ngarkohet, dhe kërkon nga gjykata që t' i shqiptohet një dënim sa më i butë .

Gjykata pas dëgjimit të prokurorit të shtetit konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga 248 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1;1.2;1.3; dhe 1.4 të KPRK-së, për pranimin e fajësisë , kështu që gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, dhe pranimi është bërë pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza si në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit, aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale me të cilin ngarkohet.

Andaj të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësin e dënimit për të pandehurin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veqanarisht lehtësuese të cilat rrethana tregojnë se edhe me shqipëtimin e dënimit me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së.

2.-

Si rrethana veqanarisht lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh faktin se ai ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, gjendjen e vështirë ekonomike –shfrytëzues i ndihmës sociale të lëshuar nga Qendra për Punë dhe mirëqenie Sociale në Novobërdë me numer 046568 , i datës 20.02.2015 ,si dhe faktin se i njëjti është mbajtës i familjes 12 anëtarsh , dhe se nuk ka asnjë burim tjetër të të hyrave përpos ndihmës sociale në shumë prej 95 Euro.

Ndërkaq në kuadrin e rrethanave rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit me rastin e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore, si dhe lëndimet e shkaktuara të dëmtuarve .

Me dënimin e shqipëtuar të pandehurit, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale si dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Gjykata në kuptim të nenit 463 paragraf. 2 të KPPRK-së, të dëmtuarit: Qibrje , Shqipe , Fidan , Besart , Gentuar Osmani, nga fshati Llabjan , Komuna e Novobërdës ,për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil .

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 paragraf. 1,nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.  
**Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem**  
**P.nr. 40/2015, më 19.10.2015**

**Sekretarja juridike**  
**Vlora Selmani – Rahimi**

**Gjyqtari**  
**Islam Thaçi,d.v.**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

3.-

**P.nr.35/ 2015**

### **NE EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem,** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Vlora Selmani – Rahimi, në lëndën penale kundër të pandehurit, Nebojsa Stankoviq nga fsh.Kllabukar, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale , Lajmërimi i rremë , apo kallximi i rremë , nga neni 390 paragrafi 4 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.820/2015, të datës 15.06.2015, të cilin e përfaqësonte Prokurori i shtetit, Arben Ismajli, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor dhe publik më12.10.2015, shpalli publikisht dhe hartoi këtë,

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri, Nebojsa Stankoviq , nga babai ,Velimir , dhe nëna, Petra , e lindur, Gjorgjeviq , i lindur më,07.01.1969 në fsh.Kllabukar ,ku edhe jeton Komuna e Novobërdës,i martuar ,prind i 3 (tre) fëmijëve , ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së varfer ekonomike , serb, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar për vepër penale,si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

### **është fajtor**

Më dt. 05.05.2015, rreth orës 19.00 , në lagjen e quajtur ,, Qeranovic,, në fshatin Kllabukar , Komuna e Novobërdës ,i pandehuri Nebosha Stankoviq , me qëllim të përfimit të kundërligjshëm pasuror për vete , me dashje ka vënë në lajthim zyrtarët policor duke bërë lajmërim të rremë se kinse në shtëpinë e babait të tij , është kryer vepra penale e vjedhjes së

rëndë , në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e vet aka lajmëruar rrejtshëm , për një vepër penale , e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare për të cilën e ka ditur se ajo vepër në fakt nuk është kryer .

Me çka ka kryer veprën penale, Lajmërimi apo kallximi i rremë , nga neni 390 paragrafi 4 I KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurëve, iu shqipton,

### **Dënim me kusht**

Ashtu që të pandehurit Nebojsa Stanković i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda afatit prej 2 (dy) vitesh , nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale , në të kundërtën dënimi me kusht ka për t`ju revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

1.-

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit Nebojsa Stanković nga fshati Kllabukar ,Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, Lajmërimi apo kallximi i rremë , nga neni 390 paragrafi 4 I KPRK-së .

Gjykata ka mbajtur seancën fillestare për shqyrtim gjyqësor në të cilën kanë prezentuar Prokurori i Shtetit, Arben Ismajli, pandehuri, Nebojsa Stanković .

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri, Nebojsa Stanković e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPRK-së, e pas këtij njoftimi i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale të kryer, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të akuzës.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare theksoj: mbesë në tërsi pranë aktit akuzues, pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestarë i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon akuzat, e për të cilin pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimi të fajësisë, mbi bazën e këtij pranimi dhe provave materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të pandehurin t`a shpalli fajtor dhe t`i shqiptoi dënim meritor në pajtim me kodin penal.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata duhet të ketë parasysh , shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore.

I pandehuri deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilin, ngarkohet, pendohet për të njejtën , dhe kërkon nga gjykata që t`i shqiptohet një dënim sa më i butë .

Gjykata pasë dëgjimit të prokurorit të shtetit konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga 248 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1;1.2;1.3; dhe 1.4 të KPRK-së, për pranimin e fajësisë , kështu që gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, dhe pranimi është bërë pasi që i njejtë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza si në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit, aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale me të cilin ngarkohet.

Andaj të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësin e dënimit për të pandehurin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veqanarisht lehtësuese të cilat rrethana tregojnë se edhe me shqipëtimin e dënimit me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së.

2.-

Si rrethana veqanarisht lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh faktin se ai ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, pendimin, gjendjen e vështirë ekonomike, mbajtës i familjes 5 anëtarsh, të ciën e mban vetëm me punën fizike, që punon kohë pas kohe.

Ndërkaq në kuadrin e rrethanave rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallen e prëgjegjësisë së të pandehurit me rastin e kryerjes së veprës penale, si dhe rrezikshmërin shoqërore.

Me dënimin e shqipëtuar të pandehurit, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale si dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 paragrafi 1, nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem  
P.nr. 35/2015, më 12.10.2015**

**Sekretarja juridike  
Vlora Selmani – Rahimi**

**Gj y q t a r i  
Islam Thaçi**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

3.-

**P.nr.33/ 2015**

### **NE EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem,** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Vlora Selmani –Rahimi, në lëndën penale kundër të pandehurit, Agim Vllasaliu nga fsh.Vllasali, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, kanosja nga neni 185 paragrafi 1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjiilan, PP.II.nr.848/2015, të datës 09.06.2015, të cilin e përfaqësonte Prokurori i shtetit, Arben Ismajli, pas mbajtjes së shqyrtimit filllestar gjyqësor dhe publik më 12.10.2015, shpalli publikisht dhe hartoi këtë,

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri, Agim Vllasaliu, nga babai Behxhet, dhe nëna Safete, e lindur Zeka, i lindur më 19.04.1957, në fsh.Vllasali, ku edhe jeton Komuna e Novobërdës, i martuar, prind i 5 (pesë) fëmijëve, ka të kryer shkollën filllore, i punësuar, i gjendjes së varfer ekonomike,

12

shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar për veprën penale, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

### **është fajtor**

Sepse më 21.05.2015, rreth orës 18.00 h, në fshatin Izvor, Komuna e Novobërdës, i pandehuri seriozisht me fjalë ka kanosur të dëmtuarin Sllavisha Stojanoviq, në atë mënyrë që ka shkuar në shtëpinë e tij dhe të dëmtuarin seriozisht e ka kanosur duke i thënë: Agim Vllasaliu do të rrezikoj dhe do të bëhet burrë deri në fund dhe Sllavisha do ta lë token e tij në fshatin Izvor, sepse atë do ta marr Agim Vllasaliu, dhe se Agim Vllasaliu do të bëjë qka të dëshiron me tërë familjen e tij, duke shtuar se mundet të dëmtuarin ta largoj edhe nga puna – shërbimi policor, me që rast tek i dëmtuari Sllavisha, ka shkaktuar ankth, frikë dhe pasiguri për jetë.

Me çka ka kryer veprën penale, Kanosja nga neni 185 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqipton,

### **Dënim me kusht**

Ashtu që të pandehurit Agim Vllasaliu i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda afatit prej 2 (dy) vitesh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'ju revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

1.-

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit Agim Vllasaliu nga fshati Vllasali, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 185 paragrafi 1 i KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën fillestare për shqyrtim gjyqësor në të cilën kanë prezentuar Prokurori i Shtetit, Arben Ismajli, i pandehuri, Agim Vllasaliu, si dhe i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, Sllavisha Stojanoviq.

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri, Agim Vllasaliu e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 paragrafi 1 i KPPRK-së, e pas këtij njoftimi i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale të kryer, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të akuzës.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare theksoj: mbesë në tërsi pranë aktit akuzues, pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestarë i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon akuza, e për të cilin pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favore të pranimi të fajësisë, mbi bazën e këtij pranimi dhe provave materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të pandehurin t'a shpalli fajtor dhe t'i shqiptoi dënim meritor në pajtim me kodin penal.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata duhet të ketë parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

I dëmtuari, Sllavisha Stojanoviq në fjalën e vet përfundimtare, deklaroi se i bashkangjitet ndjekjes penale, ndërsa nuk kërkoi kompenzimim e dëmit material, dhe kërkoj nga gjykata që i njejtë të mos më vie tek shtëpia dhe të mos më shqetësoj.

I pandehuri deklaroi se pranon fajësinë për veprën penale me të cilin, ngarkohet, pendohet për të njejtën dhe i kërkon falje të dëmtuarit, duke u arsyetuar se ditën kritike ka qenë nën ndikimin e alkoolit, dhe nuk kam mundur që ta kontrolloj veten.

Gjykata pasë dëgjimit të prokurorit të shtetit konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga 248 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1;1.2;1.3; dhe 1.4 të KPRK-së, për pranimin e fajësisë, kështu që gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, dhe pranimi është bërë pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza si në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit, aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale me të cilin ngarkohet.

Andaj të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

- 2.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësin e dënimit për të pandehurin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veqanarisht lehtësuese të cilat rrethana tregojnë se edhe me shqipëtimin e dënimit me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethana veqanarisht lehtësuese të akuzuarin gjykata pati parasysh faktin se ai ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, pendimin dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, gjendjen e vështirë ekonomike, gjegjësisht faktin se i njëjti i ka pesë fëmijë nën moshën 7 vjeqare, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin.

Ndërkaq në kuadrin e rrethanave rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallën e prëgjegjësisë së të pandehurit me rastin e kryerjes së veprës penale dhe rrezikshmërin shoqërore të këtyre veprave penale.

Me dënimin e shqipëtuar të pandehurit, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale si dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 paragraf 1, nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem  
P.nr. 33/2015, më 12.10.2015**

**Sekretarja juridike  
Vlora Selmani – Rahimi**

**Gjyqtari  
Islam Thaçi, d.v.**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

3.-

## NE EMER TE POPULLIT

**Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem,** përmes gjyqtarit të vetëm Islam Thaçi, me sekretaren juridike Vlora Selmani –Rahimi , në lëndën penale kundër të pandehurit **Bastri Abazi** nga fsh.Pasjak, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 i KPRK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.431/2015, të datës 17.03.2015, të cilin e përfaqësonte Prokurori i shtetit, Arben Ismajli, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më 12.10.2015 shpalli publikisht, dhe hartoi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri, **Bastri Abazi** ,nga babai Ilmi dhe nëna Ajnishahe , e lindur Bajrami ,i lindur më10.10.1984,në Gjilan, tani me vendbanim në fshatin Livoq i Epërm Komuna e Gjilanit ,i martuar, prind i 3 (tre) fëmijëve , ka të kryer shkollën e mesme , i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike , shqipëtar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar për veprë penale, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

### është fajtor

Sepse më 15.09.2014, në kohë të papërcaktuar, në fshatin Pasjak , Komuna e Novobërdës,nga sektori i kalibrimit në Prishtinë,është konstatuar se i pandehuri në shtëpinë e tij , me qëllim që vetit t'i sjell përfitim të kunderligjshem pasuror, pa autorizim ka shpenzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që në njëhisorin elektrik me numer .601002882 , nga ana e djathtë e ka hapur një vrimë në kapakun e njëhisorit , ashtu që përmes vrimës e ka penguar punën normale të diskut , kurse në brendi të njëhisorit , është gjetur copa druri , me qka i njejt ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike , duke e dëmtuar KEDS-in , distrikti në Gjilan në shumë prej 94.17 Euro.

Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-se .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 ,75dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqipton,

### Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit Bastri Abazi, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve dhe dënimi me gjobë në shumë prej 150 (njëqindë e pesëdhjetë) Euro , të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse mbrenda afatin prej 18 (tetëdhjetë) muajve, nga dita e plotëfuqishmërisë nuk kryen veprë tjetër penale..

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

1.-

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit Bastri Abazi nga fsh, Pasjak Komuna e Novobërdës ,për shkak të veprës penale, Vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320, të KPRK-se .

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilën kanë prezentuar Prokurori i Shtetit ,Arben Ismajli , i pandehuri Bastri Abazi ,si dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-it – Distrikti në Gjilan , Driton Rexhepi , si dhe dëshmitaret Xhelal Maliqi , dhe Agron Limani .

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri Bastri Abazi e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPRK-së, e pastaj pas këtij njoftimi i akuzuari e ka pranuar fajësinë,për veprën penale, vjedhje e sherbimeve komunale , në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të akuzës.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare thekson: mbesë në tërsi pranë aktit akuzues, pasi që në shqyrtimin e sotëm kryesor i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për të cilin pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimit të fajsisë, mbi bazën e këtij pranimi dhe provave materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpalli fajtor dhe t'i shqiptoj dënim meritot në pajtim me kodin penal.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata duhet të ketë parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale, dhe rrezikshmërinë shoqërore .

I dëmtuari,përfaqësuesi i KEDS-it, Driton Rexhepi në fjalën e vet përfundimtare deklaroj, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, për të pandehurin , pasi që i njejt i ka paguar dëmin e shkaktuar , dhe heq dorë nga kërkesa pasuroro juridike .

I pandehuri në fjalën përfundimtare, deklaroj: e pranoj fajësinë për veprën penale të kryer, pendohet për të njejtën , duke i kërkuar falje të dëmtuares, andaj i kërkoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa ma të butë.

Gjykata pasë dëgjimit të prokurorit të shtetit konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1;1.2;1.3; dhe 1.4 të KPRK-së, për pranimin e fajësisë , kështu që gjyqtari ka vlerësuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, dhe pranimi është bërë pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza si në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit, aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale andaj të pandehurin n e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësin e dënimit për të pandehurin gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rendë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

2.-

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veqanarisht lehtësuese të cilat rrethana tregojnë se edhe me shqipëtimin e dënimit me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethana veqanarisht lehtësuese të pandehurin gjykata pati parasysh faktin se ai ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, është penduar për veprën penale të shkaktuar, si dhe sjelljen e tij korrekte në gjykatë.

Ndërkaq në kuadrin e rrethanave rënduese për të gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe rrezikshmërishtë shoqërore lidhur me këtë vepër penale .

Me dënimin e shqipëtuar të pandehurit gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 parag. 1,nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem**

**P.nr. 12/2015, më 12.10.2015**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë nëafat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

3.-

**P.nr.18/ 2014**

### **NE EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem,** përmes gjyqtarit të vetëm Islam Thaçi, me sekretaren juridike Vlora Selmani –Rahimi , në lëndën penale kundër të pandehurit Dragan Vasiq nga fsh.Carrevc , Komuna e Novobërdës , për shkak të veprës penale, Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.703 /2014, të datës 01.04.2015,të cilin e përfaqësonte, Prokurorja e shtetit, Rozelida Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më 05.10.2015 shpalli publikisht, dhe hartoi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri, **Dragan Vasiq** , nga babai Millorad ,dhe nëna, Sllobodanka, e lindur Markoviq,i lindur më 08.02.1975 ,në fsh.Carrevc, Komuna e Novobërdës ,ku edhe jeton,i pamartuar , ka të kryer shkollën fillore , i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, serb , Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar për vepër penale,si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

### **është fajtor**

Më dt.30.12.2013, rreth orës 14.00 min ,në territorin e fshatit Carrevc , Komuna e Novobërdës , në pyllin e pronës shoqërore në vendin e quajtur „Progom „, të pandehurit me qëllim vjedhje , me sharrë motorike kanë prerë 3 copa trungje , Bungu me diamtëer cung 20-40cm në lartësi të drurit 18-41cm , me gjatësi –lartësi 8-18m , me vëllim të përgjithshëm 2,36m<sup>3</sup> , të cilat i kanë bartur me traktor IMT542, në këtë mënyrë të dëmtuarën APK-në zyra në Novobërdë e kanë dëmtuar në shumën prej 189 Euro.

Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4, 41,49,50,51,52 dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurëve, iu shqipton,

### **Dënim me gjobë**

Te pandehurin e gjykon me dënim me gjobë (me të holla) në shumë prej 200 €, (dyqindë) Euro, të cilin denim ka për ta paguar në afat prej 3 muajve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , në të kundërtën i njeiti do t'i zëvendësohet me dënim burgu , ashtu që për qdo 20 €,euro do të llogartiet nga një ditë burgim.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

E dëmtuara APK-ja, zyra në Novobërdë , për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në contest civil.

1.-

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit,Dragan Vasiq nga fsh.Carrevc,Komuna e Novobërdës ,për shkak të veprës penale, Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së ,

Gjykata duke vepruar sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit PA1.nr.796/2015,të datës 27.07.2015 , ka caktuar seancën kryesore , në të cilën kanë prezentuar ,Prokurorja e Shtetit ,Rozelida Hasani , i pandehuri Dragan Vasiq ,si dhe dëshmitari Sllavisha Gjokiq.

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri Dragan Vasiq e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 323 parag. 1dhe 2 nënparagrafet 2.1 , 2.2 dhe 2.3 të KPPRK-së, e pastaj pas këtij njoftimi i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë,për veprën penale, Vjedhje pylli në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të akuzës.

Prokurorja e shtetit në fjalën hyrëse deklaroj:Se më datë 05 qeroshor 2015 , ka ngritur aktakuzen PP. II. Nr . 703/2014 , për shkak të vepres penale që i vihet në barrë , dhe konsiderjmë se kjo aktakuzë, ka mbështetje në provat materiale siq janë : Fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes , fletparaqitja për dëmin e kryer si dhe llogaritja që është bërë dëmi , kërkesa e parashtuar nga drejtori i Drejtorisë Komunale , të Autoritetit pyjor në Novobërdë , dhe kopjen nga ditari i rojtarit të pyllit i datës 30 Dhjetor 2013 .

I pandehuri Dragan Vasiq , në fjalën hyrëse deklaroj , se nuk ka asnjë provë se unë e kam kryer këtë vepër penale .

Pas shqyrtimit dhe adminsitrimin të provave materiale edhe atë ,kërkesës – fletaparqitjes te partashtruar nga ana e organit kompetent , deklarates së dëshmitarit – rojtarit të pyellit Sllavisha Gjokiq . deklarates se të pandehurit Dragan Vasiq , gjykata konstatoj këtë gjendje faktike , se i pandehuri më 30.12.2013 , në kohën , vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv ka kryer vepren penale ,Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,ndaj të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuarin gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rendë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana lehtësuese të cilat rrethana tregojnë se edhe me shqipëtimin e dënimit me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41

dhe 50 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese të akuzuarin gjykata pati parasysh, gjendjen e vështirë ekonomike, si dhe sjelljen e tij korrekte në gjykatë.

2.-

Ndërkaq në kuadrin e rrethanave rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh si rrezikshmërinë shoqërore dhe shkallën e përgjigjesisë penale lidhur me këtë vepër penale.

Me dënimin e shqipëtuar të akuzuarit gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Gjykata në kuptim të nenit 463 paragraf. 2 të KPPRK-së, të dëmtuares APK-ja zyra në Novobërdë, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike, e udhëzon në kontest civil.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 paragraf. 1, nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem  
P.nr. 18/2014, më 05.10.2015**

**Sekretarja juridike  
Vlora Selmani – Rahimi**

**Gj y q t a r i  
Islam Thaçi, d.v.**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

3.-

3.-

**P.nr.08/ 2015**

19

## **NE EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem,** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Vlora Selmani –Rahimi , në lëndën penale kundër të pandehurit Agim Qerimi nga fsh.Pasjak , Komuna e Novobërdës , për shkak të veprës penale ,lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.nr.22/2015, të datës12.02.2015,të cilin e përfaqësonte Prokurori i shtetit, Esat Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor dhe publik më 21.09.2015, shpalli publikisht dhe hartoi këtë,

### **A K T G J Y K I M**

I Pandehuri Agim Qerimi, nga babai Rrahman dhe nëna , Nazife e lindur Limani, i lindur më 20.09.1960 , në fsh. Garë ,Komuna e Preshevës ,ndersa tani me vendbanim në fshatin Pasjak, Komuna e Novobërdës ,i martuar ,prind i 3 (tre) fëmijëve , ka të kryer 4 klas të shkollës filllore, i pa punë, i gjendjes së varfer ekonomike – shfrytëzues i ndihmës sociale , shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar për vepër penale,si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

### **është fajtor**

Sepse më 23 Dhjetor 2014 , rreth orës 10.00 min në fshatin Pasjak, Komuna e Novobërdës , i pandehuri Agim Qerimi, pas një mosmarrëveshje – grindje , me të dëmtuarin Ramdan Ramabaja , ka lënduar të njejtin , në atë mënyrë që me një gur , mjet ky i përshtatshëm , për shkak të lëndimit të rëndë trupor , e godet në kokë , duke i shkaktuar të dëmtuarit lëndime trupore , i cili për shkak të natyrës së lëndimeve detyrohet të kërkoj ndihmë mjeksore , në emergjencën e spitalit regjional të Gjilanit me ç,rast i shkaktohet lëndim i lehtë trupor i përshkruar sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjeko ligjor me nr.022 të dates 04.Shkurt 2015 .

Me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor , nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 I KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52, 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së,lidhur me nenin 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqipton,

### **Dënim me kusht**

Ashtu që të pandehurit i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë ) ditëve,i cili dënim nuk do t'i ekzekutohet, nëse i pandehuri brenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryenë vepër tjetër penale.

Në të kundërtën dënimi me kusht do t'i revokohet.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

1.-

I dëmtuari Ramadan Ramabaja , për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në contest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit Agim Qerimi nga fshati Pasjak Komuna e Novobërdës,për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së .

Gjykata ka mbajtur seancën fillestare për shqyrtim gjyqësor në të cilën kanë prezentuar Prokurori i Shtetit, Esat Ademi, i pandehuri, Agim Qerimi, si dhe I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, Ramdan Ramabaja.

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri, Agim Qerimi e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPRK-së, e pas këtij njoftimi i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale të kryer, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të akuzës.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare theksoj: mbesë në tërsi pranë aktit akuzues, pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestarë i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon akuza, e për të cilin pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favore të pranimi të fajsisë, mbi bazën e këtij pranimi dhe provave materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të pandehurin t'a shpalli fajtor dhe t'i shqiptoi dënim meritor në pajtim me kodin penal.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata duhet të ketë parasysh rrezikshmërinë shoqërore, shkallën e përgjegjësisë penale si dhe lëndimet e shkaktuara të dëmtuarit.

I dëmtuari, Ramadan Ramabaja në fjalën e vet përfundimtare, deklaroj se i bashkangjitet ndjekjes penale, kërkoj kompenzimin e dëmit material, dhe kërkoj nga gjykata që i njejtë të dënohet.

I pandehuri deklaron se pranon fajësinë për veprën penale me të cilin, ngarkohet, nuk pendohet për të njejtën dhe nuk i kërkon falje të dëmtuarit sepse unë kam qenë i detyruar që Ramadanit t'i shkaktoi lëndim, sepse më parë nga ai kam qenë i dëmtuar psikikisht dhe fizikisht, duke i kërkuar gjykatës që t'i shqiptoi një dënim sa ma të butë.

Gjykata pasë dëgjimit të prokurorit të shtetit konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga 248 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1; 1.2; 1.3; dhe 1.4 të KPRK-së, për pranimin e fajësisë, kështu që gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, dhe pranimi është bërë pasi që i njejtë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza si në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit, aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale me të cilin ngarkohet.

Andaj të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

2.-

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veqanarisht lehtësuese të cilat rrethana tregojnë se edhe me shqipëtimin e dënimit me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethana veqanarisht lehtësuese të akuzuarin gjykata pati parasysh faktin se ai ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, gjendjen e vështirë ekonomike – shfrytëzues i ndihmës sociale, sipas kartelës me nr. 9196858, të dat. 04.11.2014, të lëshuar nga Qendra për punë sociale në Novobërdë, si dhe faktin se i njejtë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin.

Ndërkaq në kuadrin e rrethanave rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, rrezikshmërinë shoqërore, shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit me rastin e kryerjes së veprës penale si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Me dënimin e shqipëtuar të pandehurit, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale si dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Gjykata në kuptim të nenit 463 parag. 2 të KPPRK-së, të dëmtuarin Ramadan Ramabaja, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e udhëzon në kontest civil.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 parag. 1, nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sekretarja juridike  
Vlora Selmani – Rahimi

Gjyqtari  
Islam Thaçi

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

3.-